

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI: VIDEO PROMOVUESE E PROJEKTit

Objekti: Realizimi i Videos Promovuese të Projektit.

Autoriteti kontraktues: Bashkia Përmet

Adresa: Sheshi “Abdyl Frasheri”, Përmet

E-mail: info@bashkiapermet.gov.al

1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia Përmet po implemeton projektin “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur” në kuadër të Programit Askush të mos mbetet pas LNB2 projekt i cili financohet nga SDC dhe zbatohet nga UNDP. Fokusi i këtij projekti është përmirësimi i shërbimeve për moshën e tretë dhe të moshuarit e vetmuar, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të Qendrës Ditore për të moshuarit dhe funksionalizimin e saj, rritjen e përfshirjes sociale të moshës së tretë në qytetin e Përmetit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të lidhura me këtë kategori, ofrimin e shërbimit të asistencës shtëpiake për të moshuarit e vetmuar etj. Ky projekt do të zbatohet në Përmet dhe target grupi janë të moshuarit e qytetit të Përmetit.

2. Shërbimi kërkuar

Bashkia Përmet në kuadër të projektit “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur”, është e interesuar të kontraktojë shërbimin e realizimit të videos promovuese të projektit, si pjesë e aktiviteteve të këtij projekti.

Video promovuese do të pasqyrojë qëllimin dhe aktivitetet e projektit. Materiali do të realizohet duke dokumentuar aktivitetet e projektit dhe promovuar rezultatet e tij. Materiali duhet të sigurojë vizibilitetin e duhur për donatorin e projektit, të evidentojë të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe përshtypjet e komunitetit lidhur me impaktin e projektit. Materiali final do të jetë 3-5 minuta. I gjithë materiali bruto i prodhuar do të dorëzohet kërkuar të shërbimit.

Kushtet e ofertës

- Oferta duhet të shprehet në Lek.
- Subjekti duhet të lëshojë faturë të rregullt tatimore.
- Çmimi i ofertës duhet të përfshijë të gjitha kostot që lidhen me realizimin e shërbimit si dhe detyrimet tatimore kundrejt shtetit.
- Çmimi i ofertës përbën shifrën totale dhe mbetet i pandryshuar gjatë realizimit të shërbimit.
- Pagesa për shërbimin do të realizohet vetëm nëpërmjet transfertës bankare.

Vlerësimi i ofertave do të mbështetet duke pasur si referencë kryesore përmbushjen e specifikimeve teknike dhe çmimin më të ulët.

Preferohen subjekte që kryejnë aktivitetin në Bashkinë Përmet.

Të gjithë kandidatët e interesuar (subjekte të licensuar) duhet të dërgojnë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- 1) Ftesa për ofertë e plotësuar
- 2) Kopje e licensës së subjektit (NIPT)
- 3) CV të subjektit me referenca të punëve të mëparshme.

Dokumentacioni i Ofertës do të dorëzohet nëpërmjet postës ose i skanuar nëpërmjet e-mail, jo më vonë se data 26 Shtator 2024, në adresën e mëposhtme:

Adresa e dorëzimit të ofertës:

Bashkia Përmet, Sheshi “Abdyl Frashëri”, kati IV Zyra e Protokollit, 6401, Përmet, Shqipëri ose elektronikisht në adresën: info@bashkiapermet.gov.al

Fondi limit: 25 000 Lekë me TVSH

Njoftimi i fituesit

Fituesi do të njoftohet brenda datës 01.10.2024.

MIRËPRESIM OFERTEN TUAJ

OFERTA

Emri i Subjektit _____

NIPT _____

Adresa _____

Çmimi i ofruar për realizimin e Videos Promovuese të Projektit është:

Përshkrimi i produktit	Sasia (cop)	Çmimi për njësi në LEK (TVSH e përfshirë)	Çmimi total në LEK (TVSH e përfshirë)
Video promovuese do të pasqyrojë qëllimin dhe aktivitetet e projektit. Materiali do të realizohet duke dokumentuar aktivitetet e projektit dhe promovuar rezultatet e tij. Materiali duhet të sigurojë vizibilitetin e duhur për donatorin e projektit, të evidentojë të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe përshtypjet e komunitetit lidhur me impaktin e projektit. Materiali final do të jetë 3-5 minuta. I gjithë materiali bruto i prodhuar do të dorëzohet kërkuarit të shërbimit.	1		

Data e ofertës ___/___/___

Firma/Vula _____